



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-74

PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1(b) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001).

Duke ditur se funksionimi i ligjshëm dhe efikas i veprimtarive të administratës publike, sistemeve dhe procedurave të menaxhimit dhe kontrollit në veçanti ato që kanë të bëjnë me çështjet buxhetore, financiare, fiskale dhe të prokurimit, kërkon vendosjen e një sistemi institucional për ekzekutimin e rregullt të auditimeve të brendshme në subjektet e sektorit publik;

Me qëllim të vendosjes së një sistemi të institucionalizuar si dhe autorizimin e personave përgjegjës për zbatimin e rregullt të auditimeve të brendshme në njësitë e sektorit publik, me qëllim të kontrollimit të veprimtarive të tyre të brendshme, procedurave dhe sistemeve për të përcaktuar efikasitetin si dhe respektimin e ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme.

Gjithashtu, me qëllim të autorizimit të personave të tillë për identifikimin dhe regjistrimin e të gjitha parregullsisë, mangësive dhe paligjshmërive në veprimtarinë, procedurat dhe sistemet e subjekteve të sektorit publik si dhe paraqitjen e problemeve së bashku me rekomandime para zyrtarëve dhe menaxherëve të lartë të subjekteve përkatëse të sektorit publik, dhe kur është e nevojshme para zyrtarëve të tjerë të caktuar;

Miraton:

LIGJIN PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

KREU I.
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1.1. Qëllimi i këtij ligji është vendosja e një efikasiteti më të madh operacional, një disiplinë më të madhe fiskale si dhe respektim të rregullave nga njësitë e sektorit publik, duke kërkuar që veprimtaritë, shënimet si dhe sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të të gjitha subjekteve të sektorit publik ti nënshtrohen auditimit të brendshëm sistematik dhe gjithëpërfshirës.

1.2. Qëllimi i këtij ligji është që po ashtu të sigurojë që auditimet e brendshme të kryhen me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës të subjekteve të sektorit publik në mënyrë që të ngritet niveli i shërbimeve që u ofrohen shfrytëzuesve, përfituesve si dhe qytetarëve të Kosovës.

1.3. Në këtë drejtim, ligji themelon një sistem institucional për të siguruar funksionin adekuat të auditimeve të brendshme.

Neni 2 Përkufizimet

2.1. Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij ligji, secila nga shprehjet më poshtë, do të kenë kuptimin e përshkruar në vijim, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe:

“**Zyrtari Kryesor Administrativ**” ose “ZKA” në rastin e organizatave buxhetore, nënkupton (i) Sekretarin Permanent, (ii) në organizata ku nuk ka Sekretar Permanent, atëherë Kryeshefin Ekzekutiv, ose (iii) nëse organizata nuk ka Sekretar Permanent dhe Kryeshef Ekzekutiv, atëherë personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të organizatës dhe personelit si dhe financave. Në rastin e ndërmarrjeve autonome publike që nuk janë organizata buxhetore, ky term nënkupton Kryeshefin Ekzekutiv, drejtorin menaxhues ose personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të veprimtarive, personelit dhe financave.

“**Organizatë Buxhetore**” do të thotë një autoritet ose ndërmarrje publike që drejtpërdrejtë pranon një përvetësim buxhetor sipas Ligjit për përvetësimet (ndarjet) buxhetore, përvetësim ky që nuk është pjesë e një përvetësimi tjetër të përgjithshëm që i akordohet një autoriteti ose ndërmarrje tjetër publike.

“**Autoritet Publik**” do të thotë secilën nga autoritetet vijuese: (i) një autoritetet qendror, rajonal, komunal apo lokal, organ publik, ministri, departament, autoritetet publik ose autoritet tjetër që në bazë të një ligji ose Rregulloreje të UNMIK-ut, ushtron kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative-publike apo gjyqësore, (ii) cilëndo pjesë ose nën-njësi të të lartpërmendurave;

“**Ndërmarrje Publike**” nënkupton (i) njësitë e përcaktuara në Listën A të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe (ii) të gjitha ndërmarrjet e tjera që (a) janë në pronësi publike ose janë themeluar me fonde publike ose sipas ligjit publik, dhe (b) nuk janë autoritete publike ose pjesë të autoriteteve publike.

“**Ndërmarrje Autonome Publike**” do të thotë (i) të gjitha njësitë e përcaktuara të paraqitura në Listën A të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe (ii) të gjitha ndërmarrjet tjera publike që operojnë në mënyrë autonome dhe që nuk i nënshtrohen kontrollit të drejtpërdrejtë nga një autoritet publik edhe nëse ato i nënshtrohen mbikëqyrjes së menaxhimit ose rregullimit nga ana e një autoriteti publik.

“**Ndërmarrjet e Kontrolluara Publike**” nënkupton të gjitha ndërmarrjet që nuk janë “ndërmarrje autonome publike”

“**Subjekt i sektorit publik**” është term i përgjithshëm që nënkupton dhe përfshin të gjitha autoritetet publike dhe ndërmarrjet publike në Kosovë.

“**Rregullat financiare**” do të thotë rregullat financiare të nxjerra sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

“**KBFP**” nënkupton kontrollin e brendshëm financiar publik.

“**Rregullat e KBFP**” do të thotë rregullat e KBFP-së të nxjerra sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

“**Komision i Auditimit**” nënkupton Komisionin e Auditimit të paraparë në nenin 5.

“**Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm**” ose “NJQH” do të thotë Njësinë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të themeluar sipas nenit 6 të këtij ligji.

“**Njësia e Auditimit të Brendshëm**” ose “NJAB” do të thotë Njësinë e Auditimit të Brendshëm të një organizate buxhetore ose një ndërmarrje autonome publike, të themeluar sipas nenit 9 të këtij ligji.

“**Auditori i Brendshëm**” do të thotë personin që posedon licencë aktuale dhe të vlefshme, duke përfshirë licencat e përkohshme që nxirren sipas këtij ligji.

“**Këshilltari për Auditim të Brendshëm**” do të thotë këshilltarin e angazhuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave sipas nenit 18.1 të këtij ligji.

“**Ministër**” do të thotë Ministrin e Ekonomisë dhe Financave.

2.2. Referencat në këtë ligj për ligje ose rregullore të tjera duhet të interpretohen dhe të përfshijnë edhe legjislacionin pasues të tyre.

Neni 3 Parimet

Të gjitha Njësitë e Auditimit të Brendshëm dhe Auditorët e Brendshëm duhet të bëjnë auditet e brendshme sipas parimeve në vijim:

- (a) **Ligjshmëria.** Secila Njësi e Auditimit të Brendshëm dhe secili Auditor i Brendshëm duhet të ushtrojë auditimet në pajtim të plotë me ligjin, rregullat, standardet dhe praktikat e zbatueshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ato të parapara në nenin 9.8 të këtij ligji.
- (b) **Integriteti.** Secila Njësi e Auditimit të Brendshëm dhe secili Auditor i Brendshëm duhet të ushtrojë auditimet në mënyrë profesionale dhe sipas të gjitha kushteve të zbatueshme ligjore. Auditorët e Brendshëm duhet që të evitojnë konfliktin e interesave dhe nuk duhet të lejojnë që çështjet personale të çfarëdo lloji të ndikojnë në auditimin e brendshëm që ai/ajo është duke ushtruar.
- (c) **Paanësia.** Secila Njësi e Auditimit të Brendshëm dhe secili Auditor i Brendshëm duhet të veprojnë me nivelin më të lartë të profesionalizmit gjatë mbledhjes, vlerësimit dhe transmetimit të të dhënave mbi aktivitetin ose procesin që është nën auditim. Ata duhet të bëjnë vlerësime të balancuara të të gjitha rrethanave përkatëse dhe nuk duhet të lejojnë që aktiviteti, qëndrimet ose përfundimet e tyre të ndikohen në çfarëdo mënyre nga interesat e tyre personale apo interesat e ndonjë personi tjetër.
- (d) **Fshehtësia.** Secila Njësi e Auditimit të Brendshëm dhe secili Auditor i Brendshëm duhet të respektojnë vlerat dhe pronësinë e informatave që i pranojnë dhe nuk i zbulojnë informatat para cilitdo person, përveç nëse kërkohet në mënyrë specifike sipas këtij ligji.

- (e) **Kompetenca.** Secila Njësi e Auditimit të Brendshëm dhe secili Auditor i Brendshëm duhet të posedojnë dhe përdorin diturinë, aftësinë dhe përvojën e nevojshme për zbatimin profesional të auditimit të brendshëm.
- (f) **Pavarësia.** Secila Njësi e Auditimit të Brendshëm dhe secili Auditor i Brendshëm janë plotësisht të pavarur nga aktivitetet që auditohet dhe personat përgjegjës ose të përfshirë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në aktivitetet e tilla.

Neni 4

Ushtrimi dhe qëllimi i auditimeve të brendshme

4.1. Secili subjekt i sektorit publik duhet të sigurojë që veprimtaritë, shënimet si dhe sistemet e saj të menaxhimit dhe kontrollit të nënshtrohen sistematikisht, së paku një herë në vit, një auditimit të brendshëm gjithëpërfshirës, në pajtim me dispozitat e këtij ligji nga:

- (a) një Njësi e Auditimit të Brendshëm, që sipas nenit 9.1 është e autorizuar të bëjë audimin e subjektit në fjalë, nëse njësi e tillë ekziston; ose
- (b) në rast se Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk është themeluar, atëherë nga një auditor i brendshëm i angazhuar sipas nenit 8.

4.2. Auditimet e tilla bëhen me qëllim të përcaktimit të nivelit të pajtueshmërisë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, KBFP dhe rregullat e KBFP-së, Ligjin për prokurim publik, legjislacionin për shërbimin civil si dhe ligjet, rregulloret dhe aktet e tjera nën-ligjore të lamisë fiskale dhe buxhetore.

4.3. Auditimet e tilla kryhet për të vlerësuar economicitetin dhe efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit të subjektit të audituar si dhe me qëllim të ngritjes së vlerës së njësive të sektorit publik në mënyrë që të ngritën shërbimet që u ofrohen shfrytëzuesve dhe përfituesve si dhe popullit të Kosovës.

4.4. Auditimet duhet të bëhen në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet si dhe standardet profesionale të përgatitura nga NJQH dhe të shpallura nga ministri sipas nenit 6.4.

4.5. Njësia e Auditimit të Brendshëm ose Auditori i Brendshëm që kryen një auditim të caktuar, duhet që menjëherë t'i sigurojë të gjithë anëtarëve të komisionit përkatës të auditimit raporte me shkrim në lidhje me:

- (a) identifikimin dhe përshkrimin e të gjitha shkeljeve dhe rasteve të mos-respektimit të këtij ligji dhe akteve nën-ligjore të parapara në nenin 4.2, si dhe të rekomandojë masa, duke përfshirë ato disiplinore që duhet të ndërmerren për eliminimin dhe mos-përsëritjen e shkeljeve si dhe rasteve të mos-respektimit;
- (b) identifikimin dhe përshkrimin e mangësive substanciale në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të subjektit të audituar si dhe rekomandimin e masave që duhet të ndërmerren për përmirësimin e sistemeve në fjalë;
- (c) bërjen e rekomandimeve të tjera për përmirësimin e veprimtarive dhe/ose efikasitetit të subjektit të audituar, me qëllim të ngritjes së vlerës së subjektit si dhe shërbimeve që ofrohen nga ai subjekt në të mirë të shfrytëzuesve si dhe popullit të Kosovës;

- (d) vlerësimin e masave të ndërmarrë nga subjekti përkatës i sektorit publik për zbatimin e rekomandimeve të bëra sipas pikave (a), (b) dhe/ose (c) më lartë, veçanërisht në lidhje me përcaktimin e (i) përmasave të zbatimit të rekomandimeve dhe (ii) përmirësimet e bëra si rezultat i zbatimit të rekomandimeve.

4.6. Komisioni përkatës i auditimit dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm apo Auditori i Brendshëm duhet, për së paku shtatë (7) vite, të mbajnë raportet e parapara në nenin 4.5 si dhe shënime gjithëpërfshirëse me shkrim mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me raportet si dhe të gjitha masat e ndërmarrja nga Komisioni i Auditimit si përgjegjës ndaj raporteve në fjalë. Auditori i Përgjithshëm si dhe autoritetet e tjera publik që ushtrojnë funksione hetuese ose kontrolluese duhet të kenë qasje të plotë dhe të menjëhershme në të gjitha raportet dhe shënimet sipas kërkesës.

4.7. Njësia e Auditimit të Brendshëm ose Auditori i Brendshëm përgjegjës për kryerjen e auditimit duhet që poashtu të përgatisë dhe t'u dorëzojë anëtarëve të Komisionit të Auditimit planet e parapara sipas nenit 5.2.

KREU II. INSTITUCIONET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

1. Komisionet e auditimit

Neni 5 Komisionet e auditimit

5.1. Në kuadër të çdo organizate buxhetore dhe ndërmarrje autonome publike duhet të themelohet Komisioni i Auditimit që përbëhet nga ZKA dhe së paku tre anëtarë të udhëheqësisë së organizatës buxhetore apo ndërmarrjes autonome publike. Komisioni i Auditimit i organizatës buxhetore ose ndërmarrjes autonome publike shërben si Komision i Auditimit për:

- (i) organizatën buxhetore apo ndërmarrjen autonome publike,
- (ii) komponentët, nën-njësitë si dhe degët e tyre, dhe
- (iii) cilëndo ndërmarrje të kontrolluar publike ose subjekt të sektorit publik nën kontrollin e tyre.

5.2. Njësia përkatëse e Auditimit të Brendshëm apo auditori i brendshëm duhet të përgatisin dhe dorëzojnë Komisionit të Auditimit për shqyrtim dhe miratim një plan strategjik trevjeçar në bazë të një vlerësimi të rreziqeve. Në bazë të planit të miratuar trevjeçar, Njësia e Auditimit të Brendshëm ose auditori i brendshëm, deri me 31 tetor të çdo viti kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë anëtarëve të komisionit përkatës për auditim planin vjetor për auditimin e brendshëm për vitin e ardhshëm kalendarik.

5.3. NJQH është e autorizuar që të marrë dhe shqyrtojë të gjitha planet e tilla si dhe të bëjë rekomandime të arsyeshme për ndryshim.

5.4. Me përfundimin e auditimit të brendshëm si dhe pranimit të raporteve të parapara në pikat (a), (b) dhe (c) të nenit 4.5, Komisioni i Auditimit është i autorizuar dhe ka përgjegjësinë që:

- (a) të sigurojë që menaxhmenti dhe personeli i subjektit përkatës të sektorit publik të ndërmarrin masa për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ose Auditori i Brendshëm;

- (b) të kërkojë ose të lejojë Njësinë e Auditimit të Brendshëm ose Auditorin e Brendshëm që të bëjë vlerësimin sipas pikës (d) të nenit 4.5; dhe
- (c) të raportojë të gjitha rastet e dyshuara për shkelje para autoriteteve ose institucioneve përkatëse ose të interesuara.

5.5. Komisioni i Auditimit dhe secili nga anëtarët e tij duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme:

- (a) për të siguruar pavarësinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm apo auditorit të brendshëm; dhe
- (b) që menjëherë të ndërmerren masa në rast të shkakimit të pengesave nga cilido person në punën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ose Auditorit të Brendshëm për kryerjen e një auditimi të brendshëm sipas këtij ligji; masat në fjalë përfshijnë suspendimin, largimin ose masa të tjera disiplinare ndaj personit ose personave në fjalë.

2. Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm

Neni 6

Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm

6.1. Në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave themelohet Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQH). NJQH ka statusin e departamentit të veçantë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

6.2. NJQH administrohet nga Drejtori që është shërbyes i lartë civil i emëruar sipas legjislacionit përkatës për emërimin e shërbyesve të lartë civil.

6.3. Numri i përgjithshëm i personelit në NJQH nuk duhet të kalojë pesë. I gjithë personeli janë shërbyes civil dhe punësohen nga Ministria pas konsultimit dhe lejes së Drejtorit. Personeli i NJQH i raporton Drejtorit në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve të tyre profesionale dhe administrative.

6.4. NJQH duhet të përgatisë në pajtim me këtë ligj dhe ligjet, rregullat si dhe aktet normative të parapara në nenin 4.2 dhe t'i dorëzojë Ministrit për miratim dhe shpallje, rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale për ushtrimin e auditimeve të brendshme nga Auditorët e Brendshëm dhe Njësitë e Auditimit të Brendshëm. Të gjitha rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet dhe standardet e tilla duhet të jenë në pajtim të plotë dhe të pasqyrojnë standardet e Institutit të auditorëve të brendshëm si dhe praktikave të mira të Unionit Evropian. Ministri nuk i shpall rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet apo standardet e auditimit të brendshëm pa u konsultuar së pari me NJQH.

6.5. NJQH bën vlerësimin vjetor të punës së të gjithë Auditorëve të Brendshëm dhe Njësive të Auditimit të Brendshëm.

6.6. NJQH ofron asistencë profesionale për Njësitë e Auditimit të Brendshëm dhe Auditorët e Brendshëm në të gjitha aspektet e auditimit, planet e punës, praktikat e mira evropiane në auditimin e brendshëm, si dhe cilësinë dhe funksionimin adekuat të sistemit të auditimit të brendshëm.

6.7. Jo më vonë se 1 janar 2007, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe NJQH duhet të arrazhojnë dhe institucionalizojnë një sistem rigoroz të trajnimit profesional si dhe testimin rigoroz, objektiv dhe anonim para dhe pas përfundimit të trajnimit për të gjithë personat që dëshirojnë të bëhen Auditorë të Brendshëm. Ministria dhe NJQH duhet të sigurojnë që trajnimi dhe testimi i tillë të bëhet nga ekspertë profesional dhe të kualifikuar për auditim të brendshëm që janë të licencuar ose certifikuar nga një organizatë e auditimit të brendshëm e pranuar ndërkombëtarisht.

6.8. NJQH lëshon licencën për auditor të brendshëm nëse ekspertët e auditimit të brendshëm sipas nenit 6.7 kanë dhënë rekomandim me shkrim me të cilin dëshmohet se personi përkatës ka kryer me sukses trajnimin dhe testimin dhe që sipas mendimit të ekspertëve ka treguar etikën profesionale, disiplinën dhe integritetin që kërkohet nga një auditor i brendshëm. NJQH nuk është e autorizuar të japë licencë për cilindo person në mungesë të rekomandimit të lartpërmendur me shkrim nga ekspertët e auditimit të brendshëm.

6.9. Jo më vonë se 31 dhjetor 2008, Ministria e Ekonomisë dhe Financave si dhe NJQH duhet të vendosin një sistem për arsimim të detyrueshëm profesional të personave që janë licencuar si auditorë të brendshëm sipas nenit 6.8. Ministria dhe NJQH duhet të sigurojnë që arsimimi i tillë të ofrohet nga ekspertë të kualifikuar dhe profesional të auditimit të brendshëm që janë të licencuar ose certifikuar nga një organizatë e pranuar ndërkombëtarisht për auditim të brendshëm.

6.10. NJQH - në konsultim dhe me lejen e Ministrit është e autorizuar të revokojë licencën e Auditorit të Brendshëm që:

- (i) i shkel kushtet apo dispozitat e këtij ligji,
- (ii) nuk tregon kompetencë të mjaftueshme ose nuk u përmbahet parimeve të parapara në nenin 3; ose
- (iii) nuk e përmbush kushtin e paraparë në nenin 6.9 për arsimim të vazhdueshëm për auditorë të brendshëm. Në raste të tilla, nëse personi i tillë është anëtar i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, organizata përkatëse buxhetore ose ndërmarrja autonome publike duhet që menjëherë të largojë personin të cilit i është revokuar licenca nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Personi në fjalë ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit të tillë sipas ligjit për procedurën administrative.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të NJQH

7.1. Drejtori i NJQH duhet:

- (a) ti raportojë rregullisht së paku çdo tre muaj Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe Bordit në lidhje me të gjitha aktivitetet e NJQH-s; dhe;
- (b) të përgatisë dhe dorëzojë Ministrit raportin vjetor formal me shkrim për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm. Ministria e shqyrton raportin në fjalë dhe pastaj e dorëzon raportin, së bashku me komentet e ministrit, në Qeveri, Kuvend dhe tek Auditori i Përgjithshëm.

7.2. Që nga data 30 qershor 2008, asnjë person nuk mund të shërbejë si drejtor ose anëtar i personelit profesional të NJQH nëse ai/ajo nuk ka përfunduar në tërësi trajnimin dhe testimin e paraparë në nenin 6.7 si dhe kushtet e licencimit sipas nenit 6.8. Të gjithë personat në NJQH që në atë datë nuk i kanë përmbushur kushtet e përmendura më lart, nga pikëpamja juridike, më nuk janë të kualifikuar që të shërbejnë si Drejtor ose personel profesional i NJQH-së, dhe të gjithë personat e tillë duhet që menjëherë dhe përgjithmonë të largohen nga NJQH nga organi përkatës që është i autorizuar për largimin e personit në fjalë.

7.3. Deri më 30 qershor 2008, as Drejtori dhe as personeli profesional i NJQH nuk është e nevojshme që të kenë përmbushur kushtet e parapara në nenin 6.7 dhe 6.8; me kusht që, Drejtori dhe personeli profesional i NJQH të kërkohen që, sapo të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të fillojnë trajnimin dhe testimin e në fjalë si dhe të tregojnë karakteristikat e tyre profesionale të nevojshme për marrjen e licencës. Nëse, sipas mendimit të ekspertëve të auditimit të brendshëm sipas nenit 6.7 dhe 6.8 ose sipas Këshilltarit për Auditimi të Brendshëm, Drejtori dhe personeli profesional nuk i kanë përmbushur kushtet e nevojshme sipas dispozitave të përmendura në fjalinë e parë të këtij neni 7.3, ata duhet që të njoftojë organin përkatës të autorizuar për largimin ose pushimin e përhershëm të personit përkatës nga NJQH.

Neni 8

Prokurimi i shërbimeve të auditimit të brendshëm

8.1. Nëse organizata buxhetore ose ndërmarrja autonome publike, për çfarëdo arsye, nuk e ka themeluar Njësinë për Auditimin e Brendshëm, NJQH është e autorizuar të kërkojë dhe duhet të kërkojë që organizata buxhetore ose ndërmarrja autonome publike ti nënshtrohet auditimit të brendshëm vjetor nga një Auditor i Brendshëm i prokuruar nga organizata buxhetore ose ndërmarrja autonome publike sipas këtij neni 8. Organizata përkatëse buxhetore ose ndërmarrja autonome publike duhet që menjëherë të plotësojë kërkesat e NJQH dhe Auditori i Brendshëm i prokuruar sipas këtij neni i ka të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta me ato që u open Njësive të Auditimit të Brendshëm sipas këtij ligji.

8.2. Nëse organizata buxhetore ose ndërmarrja autonome publike nuk i përmbush kushtet e parapara në nenin 8.1, NJQH duhet të njoftojë ministrin në lidhje me këtë dhe Ministri duhet të kërkojë nga auditori i përgjithshëm që menjëherë të bëjë auditimin e jashtëm të organizatës buxhetore ose ndërmarrjes autonome publike. Poashtu, personat në organizatën buxhetore ose ndërmarrjen autonome publike që janë përgjegjës për mos përmbushjen e kushteve të parapara në nenin 8.1 duhet që menjëherë ti nënshtrohen procedurës së largimit ose pushimin me ç'rast dështimi për pajtim me nenin 8.1 është bazë e mjaftueshme për largimin e ose pushimin e tyre.

8.3. Shpenzimet e auditimit të brendshëm barten nga organizata buxhetore ose ndërmarrja autonome publike.

8.4. Organizata buxhetore ose ndërmarrja autonome publike duhet që të përmbushin të gjitha kërkesat e Ligjit për prokurimin publik gjatë përzgjedhjes së Auditorëve të Brendshëm; me kusht që:

- (i) të shfrytëzohen vetëm procedurat e kufizuara të prokurimit si dhe një kopje e njoftimit të kontratës ti dërgohet të gjithë Auditorëve të Brendshëm të licencuar nga NJQH që nuk janë pjesë e një Njësie të Auditimit të Brendshëm në kuadër të ndonjë organizatë buxhetore apo ndërmarrje autonome publike;

- (ii) kriteret e përshtatshmërisë profesionale që duhet shfrytëzuar në prokurimin e tillë të vendosen nga NJQH; dhe
- (iii) vlera e kontratës vendoset pas konsultimit dhe dhënies së pëlqimit nga NJQH, me kusht që vlera e tillë të jetë vlerë absolute:
 - (a) që është e barabartë me kohën dhe përpjekjet që me arsye mendohet se janë të nevojshme për kryerjen profesionale të auditimit të brendshëm, dhe
 - (b) që me arsye pritet se do të tërheqë një numër substancial të tenderëve nga Auditorët e Brendshëm.

3. Njësitë e Auditimit të Brendshëm

Neni 9

Themelimi i Njësive për Auditim të Brendshëm

9.1. Çdo organizatë buxhetore dhe ndërmarrje autonome publike duhet të themelojnë dhe mbajnë Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

9.2. Njësia e Auditimit të Brendshëm është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që të ndërmarr auditime të rregullta të:

- (i) organizatës përkatëse buxhetore apo ndërmarrjes autonome publike,
- (ii) komponentëve, nën-njësive dhe degëve të të lartpërmendurave, dhe
- (iii) cilësdo ndërmarrje të kontrolluar publike nën kontrollin e të lartpërmendurave.

9.3. Të gjitha Njësitë e Auditimit të Brendshëm duhet të respektojnë nenin 4 dhe dispozitat e tjera të këtij ligji. Të gjitha Njësitë e Auditimit të Brendshëm duhet që po ashtu të respektojnë doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale të nxjerra nga Ministri sipas nenit 6.4 të këtij ligji.

9.4. Çdo Njësi e Auditimit të Brendshëm duhet të ketë së paku një Auditor. Organizata buxhetore ose ndërmarrja publike autonome duhet të sigurojnë, pas konsultimit me NJQH-në, që Njësia e Auditimit të Brendshëm të ketë burime të mjaftueshme për ushtrimin e përgjegjësisë të caktuara me këtë ligj.

9.5. Nëse madhësia ose veprimtaritë e organizatës buxhetore ose ndërmarrjes autonome publike janë të asaj natyre që detyrat e Njësisë së Auditimit të Brendshëm mund të ushtrohen nga një Auditor i vetëm, asgjë në këtë ligj nuk mund të interpretohet për të kërkuar që Njësia e Auditimit të Brendshëm të ketë më shumë se një Auditor. Nëse Njësisë së Auditimit të Brendshëm i nevojitet vetëm një Auditor, atëherë personi në fjalë shërben si Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, në pajtim me nenin 13.

9.6. Përveç në ndërmarrjet autonome publike, të gjithë Auditorët e Brendshëm brenda Njësisë së Auditimit të Brendshëm kanë statusin e shërbyesit civil.

9.7. Të gjithë personat duhet që të bashkëpunojnë plotësisht dhe në mënyrë të rregullt me Njësinë e Auditimit të Brendshëm si dhe të lejojnë qasje në të gjitha sistemet dhe dokumentet sipas kërkesës. Të gjithë personat duhet të respektojnë pavarësinë dhe autonominë e Auditorit të Brendshëm dhe Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

9.8. Secila Njësi për Auditim të Brendshëm dhe secili Auditor i Brendshëm duhet ti ushtrojë aktivitetet e saj në pajtim me:

- (i) këtë ligj dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Kosovë, veçanërisht ato të lëmisë buxhetore, financiare, fiskale dhe të prokurimit;
- (ii) rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale të nxjerra nga Ministri sipas nenit 6.4 të këtij ligji.

Neni 10

Përfashtime nga detyrimi për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm

10.1. Pavarësisht nga neni 9.1, NJQH me pëlqimin e Ministrit mund të përjashtojë një organizatë buxhetore ose ndërmarrje autonome publike nga përmbushja e kushteve të parapara në nenin 9.1 nëse përjashtimi i tillë arsyetohet me:

- (i) numër të pamjaftueshëm të Auditorëve të Brendshëm për t'i lejuar organizatës buxhetore që të përmbush kushtet e parapara në nenin 9.1; ose
- (ii) madhësia, buxheti ose rrethanat e tjera specifike për organizatën buxhetore ose ndërmarrjen autonome publike janë të tilla sa që, nga perspektiva e ekonomicitetit është e paarsyeshme që të kërkohet nga organizata buxhetore ose ndërmarrja autonome publike që të themelojë Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

10.2. NJQH duhet të përgatisë dhe dorëzojë Ministrit për shqyrtim, miratim dhe shpallje një përmbledhje të kriterëve transparente, mos-diskriminuese dhe racionale që duhet shfrytëzuar gjatë mundësisë të përjashtimeve të parapara me nenin 10.1.

10.3. Përjashtimet e dhëna sipas nenit 10.1 vlejnë për 24 muaj. NJQH, me pëlqimin e ministrit mund të bëjë një përjashtim të ri sipas nenit 10.1, nëse kushtet e parapara në nenin 10.1 arsyetojnë vazhdimin e përjashtimit.

10.4. NJQH me pëlqimin e Ministrit mund të revokojë një përjashtim të bërë sipas nenit 10.1 në çdo kohë, kur rrethanat që kanë arsyetuar përjashtimin e tillë nuk ekzistojnë më.

10.5. Organizatat Buxhetore ose ndërmarrjet autonome publike që kanë marrë përjashtimin sipas nenit 10.1 duhet që të përmbushin kushtet e auditimit të brendshëm sipas këtij ligji duke blerë shërbimet e një Auditori të Brendshëm sipas nenit 8.1, me qëllim të kryerjes së çfarëdo auditimi të brendshëm që kërkohet.

Neni 11

Të drejtat e Auditorëve të Brendshëm dhe Njësive për Auditim të Brendshëm

Auditori i Brendshëm ose Njësia për Auditim të Brendshëm që bëjnë një auditim të ligjshëm sipas këtij ligji, janë të autorizuar dhe kanë përgjegjësinë që:

- (a) të bëjë auditime të brendshme në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale të nxjerra nga Ministria sipas nenit 6.4 të këtij ligji;
- (b) të marrë, shqyrtojë dhe shfrytëzojë pa kufizim të gjitha të dhënat teknike, ekonomike dhe financiare dhe të tjera, si dhe informatat e dokumentet në posedim ose kontroll të subjektit të sektorit publik nën auditim;

- (c) të kopjojë të dhënat, informatat apo dokumentet e tilla për qëllime të auditimit të brendshëm si dhe të sigurojë që kopjet në fjalë të jenë ose origjinale ose të certifikuara. Dokumentet origjinale duhet ti kthehen subjektit të sektorit publik nga i cili janë marrë pas shfrytëzimit;
- (d) të kërkojë nga cilido zyrtar, punonjës, këshilltar ose kontraktues i subjektit të sektorit publik nën auditim që të ofrojë dëshmi fizike, shënime dhe/ose dëshmi gojore ose informata të tjera mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditimin ose mbi aktivitetet që janë nën auditim;
- (e) të ketë qasje pa pengesë në stabilimentet e subjektit të sektorit publik nën auditim, dhe të verifikojë dhe vlerësojë vlerat materiale dhe monetare të subjektit të sektorit publik në pajtim me rregullat dhe legjislacionin;
- (f) të rekomandojë masat që duhet të ndërmerren nga subjekti përkatës sipas nenit 4.5;
- (g) të marrë informata të certifikuara nga Thesari, BPK dhe cilado organizatë publike apo private në lidhje me xhirollogaritë aktuale apo të mbyllura dhe/ose transaksionet e/ose që përfshijnë subjektet nën auditim mbi të cilin Njësia për Auditim të Brendshëm ka kompetenca sipas nenit 9.1; dhe
- (h) që menjëherë të raportojë të gjitha pengesat, refuzimet apo hezitimet nga cilido person para Komisionit të Auditimit. Komisioni përkatës i auditimit duhet të hetojë rastin, dhe nëse konstatohet, Komisioni i Auditimit ndërmerr masat e parapara me nenin 5.5.

Neni 12 Ndalesat

12.1. Asnjë person nuk mund të kryejë aktivitete të auditimit të brendshëm ose të ofrojë shërbime të auditimit të brendshëm për një subjekt të sektorit publik nëse ai/ajo nuk posedon licencë aktuale dhe të vlefshme të lëshuar në pajtim me këtë ligj.

12.2. Asnjë person nuk mund të marrë licencë për auditim të brendshëm nëse ai/ajo:

- (a) ka punuar ose ka kryer në tri (3) vitet e fundit ndonjë pozitë ose funksion në një parti politike;
- (b) në pesë (5) vitet e fundit është dënuar për një vepër penale;
- (c) është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka krye vepër penale ose kundërvajtje që përfshin mashtrimin, keqinterpretimin, korrupsion, pastrim parash, përvetësim, keqpërdorim ose keqpërvetësim të fondeve, mito ose ryshfet sipas ligjeve ose rregulloreve të zbatueshme në Kosovë ose në ndonjë vend apo juridiksion tjetër, ose sipas konventave apo traktateve ndërkombëtare;
- (d) është konstatuar se ndonjëherë ka qenë i përfshirë në sjellje jo-profesionale nga ndonjë gjykatë, organ ose organizatë përgjegjëse për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale; ose
- (e) ka bërë ndonjëherë paraqitje të shtrembëruar nën betim ose në ndonjë dokument të vulosur, të notarizuar ose zyrtar.

12.3. Asnjë person nuk mund të kryejë aktivitete të auditimit të brendshëm ose të ofrojë shërbime të auditimit të brendshëm për një subjekt të sektorit publik nëse ai/ajo aktualisht mban pozitë ose kryen punë për një subjekt të sektorit publik përveç subjektit që rregullisht dhe ligjërisht ofron shërbime profesionale dhe të pavaruara të auditimit.

12.4. Auditori i Brendshëm nuk mund të kryejë aktivitete të auditimit të brendshëm ose të ofrojë shërbime të auditimit të brendshëm për subjekte të sektorit publik nëse ai/ajo:

- (a) paraprakisht ka qenë i punësuar ose i angazhuar në ndonjë pozitë ose kapacitet që ka qenë nën kontrollin e ndonjë anëtarit të menaxhmentit të lartë të atij subjekti të sektorit publik; ose
- (b) në tri (3) vitet e fundit ka qenë i punësuar ose i angazhuar në ndonjë pozitë ose kapacitet përveç si Auditor i Brendshëm.

Neni 13

Drejtorët e Njësive për Auditim të Brendshëm

13.1. Secila Njësi për Auditim të Brendshëm në kuadër të një organizate buxhetore apo ndërmarrje autonome publike duhet të ketë drejtorin e saj. Secili drejtor i tillë duhet të jetë njëkohësisht Auditor i Brendshëm. Ai/ajo emërohet nga organizata buxhetore apo ndërmarrja autonome publike; sidoqoftë, emërimi në fjalë nuk hyn në fuqi pa pëlqimin me shkrim të NJQH, pëlqim ky që nuk duhet të vonohet pa arsye.

13.2. Drejtori i një Njësie për Auditim të Brendshëm është përgjegjës për:

- (a) Menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit dhe veprimtarive të Njesisë për Auditim të Brendshëm;
- (b) Përzgjedhjen, në bazë konkurruese dhe pas konsultimit me NJQH sipas nenit 9.4, të Auditorëve të Brendshëm shtesë që janë të nevojshëm për Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Përzgjedhja e tillë bëhen në bazë të një liste të Auditorëve të Brendshëm e siguruar nga NJQH. Përzgjedhja e tillë duhet që po ashtu të jetë në pajtim me ligjet e tjera të zbatueshme në Kosovë, duke përfshirë, përveç në rastin e ndërmarrjeve autonome publike, legjislacionin për shërbimin civil;
- (c) Sigurojë shfrytëzimin produktiv, ekonomik dhe efikas të burimeve të Njesisë për Auditim të Brendshëm;
- (d) Sigurojë zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregullave, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve të përcaktuar në nenin 9.8;
- (e) Sigurojë përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të planeve të përcaktuara në nenin 5.2;
- (f) Organizojë, kryejë dhe mbikëqyrë ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm të ndërmarrja nga NJAB, si dhe dorëzimin e rezultateve të auditimit para Komisionit të Auditimit të organizatës buxhetore apo ndërmarrjes autonome publike;
- (g) Përgatitë dhe dorëzojë raporte tremujore dhe vjetore mbi të gjitha aktivitetet e auditimit të NJAB tek Komisioni i Auditimit i organizatës buxhetore apo ndërmarrjes autonome publike.

13.3. Për shkak të nivelit të lartë të kompetencës që kërkohet nga Drejtori i Njesisë për Auditim të Brendshëm, ai/ajo ka rrogën e njëjtë me atë të një Sekretari Permanent.

Neni 14
Përgjegjësitë e ZKA-së në Auditimin e Brendshëm

Secili ZKA i një organizate buxhetore apo ndërmarrje autonome publike:

- (a) duhet të sigurojë që NJAB ose Auditori i Brendshëm ka burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe të tjera për ushtrimin efikas të detyrave dhe përgjegjësi të saj;
- (b) të sigurojë ndërmarrjen e masave të shpejta dhe efektive për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, Auditori i Brendshëm, Komisioni i Auditimit dhe/ose NJQH;
- (c) duhet të eliminojë parregullsitë e zbuluara gjatë auditimit si dhe zbatimin e masave për të parandaluar parregullsitë e tilla në të ardhmen;
- (d) është përgjegjës për të siguruar që organizata buxhetore apo ndërmarrja autonome publike i përmbush të gjitha kushtet e parapara në këtë ligj; dhe
- (e) është përgjegjës për të siguruar që të gjithë shërbyesit civil dhe personat e punësuar apo të angazhuar nga organizata buxhetore, ndërmarrja autonome publike apo ndonjë njësi tjetër e cekur në nenin 9.1:
 - (i) ti mundësojnë NJAB ose Auditorit të Brendshëm qasje të lirë në të gjitha dokumentet, shënimet, zyrat dhe stabilimentet që janë të nevojshme për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të NJAB-së ose auditorit të brendshëm; dhe
 - (ii) ndërmarrin masa aktive për të asistuar dhe për të lehtësuar punën e NJAB-së ose auditorit të brendshëm në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

Neni 15
Rekrutimi, kualifikimi dhe trajnimi i auditorëve të brendshëm

Personat që dëshirojnë të certifikohen si auditorë të brendshëm, duhet:

- (a) të posedojnë në minimum, (i) diplomë universiteti në administratë publike, financa publike, kontabilitet apo juridik; ose (ii) licencë ose certifikatë të vlefshme për auditim të brendshëm të lëshuar nga një juridiksion jashtë Kosovës, në pajtim me standardet e Institutit të auditorëve të brendshëm.
- (b) ti përmbushin kushtet e tjera të arsyeshme të vendosura nga NJQH, me këshillën dhe pëlqimin e ekspertëve të auditimit të brendshëm sipas nenit 6.7, për të siguruar kompetencën, ndershmërinë, integritetin dhe objektivitetin e kandidatit.
- (c) të kenë përfunduar me sukses trajnimin, testimin dhe licencimin sipas nenit 6.7 dhe 6.8 të këtij ligji; dhe
- (d) të mos jenë të pa-pranueshëm për shkak të arsyeve të cekura në nenin 12.2.

Neni 16 Konflikti i Interesave

16.1. Secili auditor i brendshëm duhet që menjëherë të njoftojë Komisionin e Auditimit dhe NJQH me shkrim mbi konfliktet potenciale të interesit që mund të shfaqen si rezultat i auditimit.

16.2. Konflikti i interesave ekziston nëse auditimit përfshin apo ka të bëjë me:

- (a) subjekti i sektorit publik në të cilin Auditori i Brendshëm ka qenë i punësuar ose i angazhuar në çfarëdo kapaciteti tjetër përveç si Auditor i Brendshëm sipas këtij ligji, në tri vitet e fundit;
- (b) subjekti i sektorit publik në tri vitet e fundit ka pasur në menaxhment apo ndër zyrarët e lartë politik, një person me të cilin Auditori i Brendshëm:
 - (i) ka pasur marrëdhënie afariste apo marrëdhënie të tjera substanciale në tri vitet e fundit, ose
 - (ii) ka marrëdhënie familjare deri në brezin e tretë siç përcaktohet në legjislacionin për Shërbimin Civil; ose
- (c) një subjekt i sektorit publik në të cilën apo me të cilën, cilido nga personat në vijim ka pasur marrëdhënie afariste në tri vitet fundit:
 - (i) Auditori i Brendshëm,
 - (ii) një person me të cilin Auditori i Brendshëm ka pasur marrëdhënie afariste apo marrëdhënie të tjera substanciale në tri vitet e fundit,
 - (iii) cilido person me të cilin auditori i brendshëm ka marrëdhënie familjare deri në brezin e tretë siç përcaktohet në legjislacionin për shërbimin civil.

16.3. Gjatë përgatitjes së rregullave dhe standardeve profesionale të cekura në nenin 6.4, NJQH mundet, nëse është në pajtim me standardet e Institutit të Auditorëve të Brendshëm dhe praktikat e Unionit Evropian, të specifikojë në rregullat dhe standardet e tilla edhe situatat e tjera që përbëjnë konflikt interesash.

16.4. Auditoret e Brendshëm me konflikt interesash nuk mund të marrin pjesë, të diskutojnë ose të përpiqen të ndikojnë në çfarëdo mënyre në ushtrimin e auditimit.

16.5. Nëse një person pranon informata se një auditim i brendshëm është ose ishte kryer nga një auditor i brendshëm me konflikt interesi, NJQH duhet të informohet menjëherë dhe NJQH duhet të hetojë rastin dhe nëse konstatohet, të bëhet suspendimi i licencës së auditorit përkatës dhe angazhimi i një auditori të ri nga ana e organizatës buxhetore ose ndërmarrjes autonome publike për rifillimin e auditimit të brendshëm sipas nenit 8. auditimi fillestar zhvlehtësohet, por të gjitha dokumentet e zhvilluara gjatë atij auditimit duhet të merren nga Komisioni i Auditimit dhe NJQH si fakte në rast se auditori paraprak ka treguar neglizhencë ose keqpërdorime të qëllimta.

KREU III.
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17
Marrëdhënia me Auditimin e Jashtëm

NJQH duhet të bashkëpunojnë me Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës:

- (a) për të zhvilluar një marrëdhënie reciproke të mirëkuptimit ndërmjet tyre;
- (b) për të evituar dyfishimin e punës në auditim;
- (c) për shkëmbimin adekuat të informatave; dhe

Neni 18
Dispozitat kalimtare

18.1. Deri në atë kohë kur Drejtori dhe personeli profesional i NJQH-së të jenë trajnuar dhe licencuar si auditorë të brendshëm në pajtim me nenin 6 dhe 7 të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të prokurojë, drejtpërdrejt ose përmes një donatori - shërbimet e një Këshilltari për Auditim të Brendshëm, që është i autorizuar dhe ka përgjegjësinë të asistojë dhe mbështesë NJQH-në në bazë ditore. Këshilltari për Auditim të Brendshëm duhet të jetë ekspert profesional dhe i kualifikuar i auditimit të brendshëm që është i licencuar ose certifikuar nga një organizatë e pranuar ndërkombëtarisht për auditim të brendshëm.

18.2. Kur është e nevojshme për ti mundësuar Auditorit të Brendshëm që të kryejë funksionet dhe detyrat e tij në mënyrë profesionale sipas këtij ligji, Ministria duhet të prokurojë - drejtpërdrejt ose përmes një donatori - shërbimet e një eksperti të ngjashëm profesional dhe të kualifikuar për të asistuar Këshilltarin për auditim të brendshëm.

18.3. Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të ketë si prioritet të lartë prokurimin e shërbimeve të Këshilltarit për auditim të brendshëm sipas nenit 18.1, ekspertin tjetër të cekur në nenin 18.2 si dhe trajnerët e kërkuar sipas nenit 6.7. Ministria duhet të inicojë aktivitetin e prokurimit jo më shumë se tridhjetë (30) ditë pas shpalljes së këtij ligji, dhe duhet të përmbyllë aktivitetin e prokurimit jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë pas inicimit.

18.4. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, përderisa drejtori dhe së paku tre anëtarë të personelit të NJQH të jenë trajnuar dhe licencuar si Auditorë të Brendshëm sipas nenit 6 dhe 7 të këtij ligji:

- (i) Ministri dhe Drejtori i NJQH duhet që së pari të kërkojnë qëndrimin me shkrim të Këshilltarit për auditim të Brendshëm në lidhje me të gjitha masat ose aktivitetet që ata propozojnë ose planifikojnë ti ndërmarrin në bazë të autorizimit të dhënë sipas këtij ligji osë që përndryshe kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm; dhe
- (ii) në veçanti, Ministri nuk do të shpallë rregulla, politika, materiale, udhëzime ose standarde profesionale sipas këtij ligji, pa marrjen e qëndrimit me shkrim të Këshilltarit për Auditim të Brendshëm dhe, siç kërkohet nga neni 6.4, këshillat e NJQH-së.

18.5. NJQH, menjëherë pas angazhimi të Këshilltarit për auditim të brendshëm dhe ekspertit tjetër të auditimit të brendshëm sipas nenit 18.1 dhe 18.2, duhet të bëjë përpjekje të koordinuara dhe serioze pa i shpërfillur kërkesat e këtij ligji për:

- (a) përpilimin dhe dorëzimin para Ministrit për shqyrtim dhe shpallje, të politikave, udhëzimeve, doracakëve dhe standardeve të theksuara në nenin 6.4; dhe
- (b) rekrutimin e personave të kualifikuar për fillimin e trajnimit të brendshëm në pajtim me nenin 6.7.

18.6. Nëse është e nevojshme, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të sigurojë fondet e nevojshme për shërbimet e Këshilltarit për Auditim të Brendshëm dhe ekspertëve të tjerë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 dhe/ose trajnerit profesional për auditim të brendshëm sipas nenit 18.5 (b). Në raste të tilla, Departamenti i Prokurimit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave duhet të bëjë prokurimin e tillë. Kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik duhet të respektohet plotësisht gjatë përzgjedhjes së personave në fjalë; me kusht që:

- (i) të shfrytëzohet vetëm procedurat e kufizuara të prokurimit sipas Ligjit për Prokurim;
- (ii) departamenti përkatës i prokurimit duhet të caktojë vlerën e prokurimit dhe kriteret e përshtatshmërisë profesionale në atë shumë që pritet se do të tërheqë tender nga të paktën 3 ekspertë të kualifikuar dhe profesional të auditimit të brendshëm; dhe
- (iii) njoftimi i kontratës duhet të botohet në publikime me qarkullim të gjërë në Evropë.

Neni 19 Licencat e përkohshme

19.1. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, NJQH mundet, pas konsultimit dhe marrjes së pëlqimit nga Këshilltari për Auditim të Brendshëm, të lëshojë licenca të përkohshme për auditorë të brendshëm, më së shumti dhjetë (10) personave që Drejtori dhe NJQH si dhe Këshilltari për Auditim të Brendshëm mendojnë se kanë akumuluar përvojë substanciale për tu lejuar atyre që të kryejnë shërbime bazike të auditimit të brendshëm sipas këtij ligji. Licenca e përkohshme nuk i lëshohet personit që është i pa-pranueshëm sipas nenit 12.2.

19.2. Të gjitha licencat e përkohshme skadojnë me 31 dhjetor 2008 dhe nuk mund të ri-përtërihen. Autorizimi i NJQH për lëshimin e licencave të tilla poashtu skadon në atë datë.

19.3. Të gjithë personat që posedojnë licencë të përkohshme konsiderohet si Auditorë të Brendshëm të licencuar për qëllime të këtij ligji, prandaj kanë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e njëjta me ato të Auditorëve të Brendshëm të licencuar; me kusht që, të gjithë personat që kanë licencë të përkohshme sa më shpejtë që të jetë mundshme pas pranimit të licencës, duhet të fillojnë dhe të ndjekin trajnimin dhe testimin sipas këtij ligji, për të dëshmuar karakteristikat e kërkuara për marrjen e licencës normale sipas nenit 6.7 dhe 6.8. Nëse, sipas mendimit të ekspertëve të auditimit të brendshëm të përmendur në nenin 6.7 dhe 6.8 ose mendimit të Këshilltarit për Auditim të Brendshëm, poseduesi i një licence të përkohshme nuk e përmbush secilën nga elementet e dispozitave në fjalë dhe pare të këtij neni, paragrafi 19.3, ata duhet të njoftojnë NJQH mbi rastin e tillë dhe NJQH është e detyruar që të revokojnë licencën e përkohshme të personit në fjalë.

Neni 20
Marrëdhënia me ligjet e tjera

Në rast të konfliktit ndërmjet këtij ligji dhe dispozitave të legjislacionit paraprak në lidhje me auditimin e brendshëm të subjekteve të sektorit publik, atëherë ky ligj mbizotëron.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-74
16 nëntor 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha